



## Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 30 qershor 2021

### Njoftim për shtyp

### Zhvillime të rëndësishme në normat e interesit të bankave dhe shtëpive të kursimit<sup>1</sup>: maj, 2021

–Në maj të vitit 2021, norma mesatare e interesit të totalit të kredive shënon 4,56%, duke vazhduar kështu trendin e rënies mujore dhe vjetore prej 0,02 p.p. dhe 0,27 p.p. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave është 0,85% dhe shënoi rënie në bazë mujore dhe vjetore, prej 0,05 p.p. dhe 0,25 p.p.

- Në maj, norma mesatare e interesit e kredive të reja<sup>2</sup> është 3,84%, e cila paraqet një rënie mujore dhe vjetore prej 0,25 p.p. dhe 0,08 p.p. Norma mesatare e interesit për depozitat e reja regjistron rritje identike mujore dhe vjetore prej 0,05 p.p. dhe është 0,67%.

Tabela 1. Norma të interesit të totalit dhe kredive dhe depozitave të reja<sup>345</sup>

	5.2020	6.2020	9.2020	12.2020	1.2021	2.2021	3.2021	4.2021	5.2021
во % на годишно ниво									
<b>Вкупни кредити</b>	<b>4.83</b>	<b>4.80</b>	<b>4.70</b>	<b>4.63</b>	<b>4.62</b>	<b>4.61</b>	<b>4.59</b>	<b>4.58</b>	<b>4.56</b>
Корпоративен сектор	3.97	3.93	3.80	3.73	3.71	3.70	3.70	3.70	3.68
Домаќинства	5.64	5.63	5.53	5.46	5.45	5.43	5.40	5.37	5.35
<b>Новоодобрени кредити</b>	<b>3.92</b>	<b>3.94</b>	<b>3.99</b>	<b>3.78</b>	<b>3.98</b>	<b>4.25</b>	<b>3.94</b>	<b>4.09</b>	<b>3.84</b>
Корпоративен сектор	3.71	3.68	3.82	3.42	3.60	3.76	3.51	3.85	3.31
Домаќинства	4.43	4.42	4.51	4.38	4.56	4.68	4.61	4.49	4.61
<b>Вкупни депозiti</b>	<b>1.10</b>	<b>1.09</b>	<b>0.98</b>	<b>0.95</b>	<b>0.93</b>	<b>0.92</b>	<b>0.89</b>	<b>0.90</b>	<b>0.85</b>
Корпоративен сектор	1.24	1.27	1.14	1.22	1.22	1.20	1.15	1.19	1.16
Домаќинства	1.08	1.07	0.96	0.92	0.89	0.88	0.86	0.87	0.82
<b>Новопримени депозiti</b>	<b>0.62</b>	<b>0.64</b>	<b>0.76</b>	<b>0.68</b>	<b>0.62</b>	<b>0.71</b>	<b>0.76</b>	<b>0.62</b>	<b>0.67</b>
Корпоративен сектор	0.34	0.43	0.74	0.38	0.40	0.39	0.75	0.65	0.74
Домаќинства	0.91	0.85	0.78	0.85	0.66	0.86	0.77	0.61	0.64

Burimi: BPRMV

<sup>1</sup> „Normë interesi“ do të thotë një normë mesatare e ponderuar e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm, shih Metodologjinë:

[http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija\\_MIR\\_07\\_2018\\_mak.pdf](http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_MIR_07_2018_mak.pdf)

<sup>2</sup> Zhvillime të ndryshueshme janë karakteristike sa u përket normave të interesit të kredive/depozitave të reja. Zhvillimet e këtylla të normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e rënë dakord rishtazi e interesit.

<sup>3</sup> Efektet e ndryshimeve në metodologjinë të publikuar në informacionin e 20 korrikut të vitit 2018


([www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija\\_za\\_promeni\\_vo\\_monetarnata\\_statistika\\_mk.pdf](http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf)) nuk vërehen në kategoritë individuale të normave të interesit të depozitave/kredive (në denarë pa klauzolë valutore, në denarë me klauzolë valutore dhe në valutë të huaj), por vetëm në normat agregate të interesit (në denarë dhe valutë të huaj) të cilat nuk janë subjekt i analizës në njoftim, por publikohen në internet faqen e BPRMV-së.

<sup>4</sup> Në gusht të vitit 2020 revokohet leja për themelim dhe punë e një banke. Të dhënat për normat e interesit për korrik të vitit 2020 i përfshijnë të dhënat e qershorit për normat e interesit për këtë bankë.


<sup>5</sup> Të dhënat për normat e interesit të muajit gusht të vitit 2020, nuk i përfshijnë të dhënat për një bankë të cilës në gusht të vitit 2020 i është revokuar leja për themelim dhe punë dhe për të cilën është iniciuar një procedurë falimentimi.

## 1. Normat e interesit të sektorit të korporatave<sup>6</sup>

- Norma mesatare e interesit të totalit të kredive të miratuara në sektorin e korporatave, këtë muaj, regjistroi një rënie mujore prej 0,02 p.p. dhe është 3,68%. Kjo rënie është për shkak të uljes së normave të interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,03 p.p. dhe 0,01 p.p.) në kushte të rritjes minimale të normave të interesit të kredive në valutë të huaja (për 0,01 p.p.). Analizuar në bazë vjetore, norma e interesit e totalit të kredive të sektorit të korporatave ulët për 0,29 p.p.




Burimi: BPRMV



- Në maj, norma e interesit të kredive të reja të sektorit të korporatave është më e ulët për 0,54 p.p. në bazë mujore dhe është 3,31%. Ndryshimi në rënie është si rezultat i rënies së normave të interesit në të gjithë komponentët, edhe atë: norma e interesit të kredive në denarë me dhe pa klauzolë valutore (për 0,61 p.p. dhe 0,41 p.p.), si dhe normat e interesit të kredive në valutë të huaja (për 0.29 p.p.). Krahasuar me muajin maj të vitit të kaluar, kjo normë interesi është më e ulët për 0,40 p.p.



Burimi: BPRMV




<sup>6</sup> Për nevojat e këtij njoftimi, sektori i korporatave i përfshin institucionet jofinanciare (publike dhe të tjera).

## Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë


- Në maj, norma e interesit të totalit të depozitave të sektorit të korporatave është 1,16% dhe krahasuar me muajin e kaluar është më e ulët për 0,03 p.p. Rënia mujore është si rezultat i zvogëlimit të normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe normat e interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,03 p.p. dhe 0,02 p.p.), me norma interesi të pandryshuara të depozitave në denarë me klauzolë valutore. Krahasuar në bazë vjetore, norma e interesit e totalit të depozitave të sektorit të korporatave është ulur për 0,08 p.p.

- Këtë muaj, norma e interesit të depozitave të reja<sup>7</sup> të sektorit të korporatave, rritet për 0,09 p.p. dhe është 0,74%. Rritja kryesisht është për shkak të rritjes së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,30 p.p.), në kushte kur normat e interesit të depozitave në valutë të huaj dhe normat e interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore janë zvogëluar (për 0,44 p.p. dhe 0,07 p.p.). Në bazë vjetore, kjo normë interesi shënoi rritje prej 0,40 p.p.

### 2. Normat e interesit të amvisërive<sup>8</sup>



Burimi: BPRMV




- Në maj, norma e interesit e totalit të kredive për amvisëritë shënon një rënie mujore prej 0,02 p.p. dhe është zvogëluar në 5,35%. Analizuar sipas strukturës së valutës, rënia kryesisht është si rezultat i zvogëlimit të normave të interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,03 p.p.), ndërsa normat e interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore dhe norma interesi të kredive në valutë të huaj në bazë mujore është e pandryshueshme. Krahasuar me muajin maj të vitit 2020, norma e interesit të totalit të kredive për amvisëritë është ulur për 0,29 p.p.

<sup>7</sup> Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të reja të sektorit të korporatave, ndërprerja në serinë e të dhënave për normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit se në muaj të caktuar bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë marrë depozita të tilla nga sektori i korporatave.

<sup>8</sup> Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshinë: persona fizikë, persona të vetëpunësuar dhe institucioni jofitimprurëse të cilat u shërbejnë amvisërive

## Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në maj, norma mesatare e interesit të kredive të reja për amvisëritë është 4,61%, që paraqet rritje prej 0,12 p.p. në baze mujore. Ndryshimi në rritje vjen nga rritja e normave të interesit të kredive në valutë të huaj dhe normat e interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,35 p.p. dhe 0,02 p.p.), dhe një rënieje të normave të interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore (për 0,02 p.p.). Kjo normë interesi shënon rritje për 0,18 p.p. në bazë vjetore.



Burimi: BPRMV



- Norma e interesit të depozitave totale për amvisëritë, në maj është ulur për 0,05 p.p. dhe arriti në 0,82%. Rënia, është për shkak të uljes së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe normat e interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,07 p.p. dhe 0,03 p.p.), ndërsa normat e interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore janë të pandryshueshme. Krahasuar në bazë vjetore, norma e interesit është ulur për 0,26 p.p.

- Në maj, norma e interesit të depozitave të reja për amvisëri<sup>9</sup> është 0,64%, me rritje mujore të realizuar prej 0,03 p.p. Kjo rritje kryesisht i detyrohet rritjes së normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,06 p.p.), në kushtet ku depozitat në denarë me klauzolë valutore nuk janë pranuar, megjithatë është realizuar rënie e normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,02 p.p.). Norma e interesit të depozitave të reja për amvisëri është ulur për 0,27 p.p. krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

<sup>9</sup> Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të reja të amvisërive, ndërprerja në seritë e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muajt të caktuar bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.

**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Drejtoria për Statistikë**

\*\*\*

**Informacione shoqëruese**

Të dhënat e serive kohore: Të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe shtëpive të kursimit  
[http://www.nbrm.mk/statistika\\_na\\_kamatni\\_stapki.nspix](http://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki.nspix)

Shpjegime metodologjike:

<https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjija/Metodologjija>

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

[http://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar\\_na\\_objavuvanje\\_podatoci.pdf](http://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf)

Të dhëna mujore për normat e interesit: 30 qershor 2021 (mesatare referuese duke përfshirë edhe qershorin e 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: [contact.statistika@nbrm.mk](mailto:contact.statistika@nbrm.mk) ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 112/110/108).